



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo**  
**Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

---

Në pajtim me nenin 132 dhe 133 të Kushtetutës të Republikës të Kosovës, Ligjin nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, Rregulloren nr.01/2016 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Institucionin e Avokatit të Popullit, Rregulloren e punës në Institucionin e Avokatit të Popullit nr.02/2016 dhe Rregulloren nr.02/2017 për procedurën e rekrutimit, emërimit dhe punës provuese të nëpunësve në Institucionin të Avokatit të Popullit, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall:

**K O N K U R S**

**I. Titulli i vendit të punës:** Këshilltar i lartë juridik për çështje juridike, një (1) pozitë

Numri i referencës: 4/2017

Grada/Koeficienti: Niveli Profesional – G3/16.77

Mbikqyrësi: Drejtori departamentit për çështje juridike

Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat, duke përfshirë periudhën e punës provuese 1(një) vjeçare.

Vendi: Prishtinë.

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës:**

1. Kryen hulumtime dhe bënë analiza lidhur me zbatimin e ligjeve, rregulloreve, standardeve dhe rekomandimeve të mekanizmave vendor dhe ndërkombëtare, në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, dhe të njëjtat ia përcjell drejtorit të departamentit për veprim të mëtejshëm.
2. Përgatit shprehjen e opinioneve në procesin e përgatitjes së projektligjeve dhe rregulloreve të tjera, të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, dhe të njëjtat ia përcjell drejtorit të departamentit për veprim të mëtejshëm.
3. Përgatit rekomandime për nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës, dhe të njëjtat ia përcjell drejtorit të departamentit për veprim të mëtejshëm.
4. Përgatit rekomandime për Kuvendin dhe Qeverinë e Kosovës lidhur me harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut, si dhe zbatimin e tyre efektiv si dhe në përgatitjen e inicimit në Gjykatën Kushtetuese të çështjeve lidhur me përputhshmërinë me Kushtetutën të ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit, të rregulloreve të Qeverisë dhe të Statutit të Komunës
5. Ofron këshilla dhe përgatit rekomandime për autoritet e Republikës së Kosovës lidhur me programet dhe politikatat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës dhe të njëjtat i'a përcjell drejtorit të departamentit për veprim të mëtejshëm.
6. Ofron këshilla dhe jep rekomandime, në përputhje me procedurën e përcaktuar dhe sipas kërkesës së parashtruar, çdo personi fizik dhe juridik lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve dhe akteve nënligjore me standardet e pranuar ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe të njëjtat i'a përcjell drejtorit të departamentit për veprim të mëtejshëm.
7. Ndihmon në fillimin e procedimit apo konfliktit administrativ në mbrojtje të interesave publike, në rast se konsiderohet se me aktin administrativ është shkelur ndonjë e drejtë apo ndonjë interes i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, i bazuar në këtë ligj si dhe përgaditë informatën për organin kompetent për fillimin e hetimeve penale, nëse gjatë shqyrtimit të rasteve dhe hulumtimit vëren se ka elemente të veprës penale.
8. Ndihmon në inicimin e ngritjes së procedurës, me pëlqimin paraprak të parashtruesit të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut apo me iniciativë të IAP-it, në koordinim me departamentet përkatëse, lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive të një numri më të madh të qytetarëve, të fëmijëve apo personave me aftësi të humbura veprimi.
9. Merr pjesë aktive në të gjitha fazat e hartimit, realizimit dhe implementimit të politikave të administrimit, planeve dhe programeve strategjike, si dhe projekteve të IAP-it për arritjen e misionit dhe objektivave strategjike të IAP-it.

10. Udhëheq grupet punuese në çështjet profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë, ofron këshilla në fushën e ekspertizës të kërkuar brenda IAP-it si dhe ofron këshilla për stafin e nivelit më të ulët brenda departamentit për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësive të tyre;
11. Përcjell jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në rastet e padive kundër shkeljes së të drejtave të njeriut dhe jurisprudencën e brendshme, si dhe rregulloret dhe standardet e tjera ndërkombëtare lidhur me zbatimin e mbrojtjes me kohë të të drejtave të palëve të dëmtuara dhe ofrimit të ndihmës organeve administrative, të cilat vendosin mbi të drejtat dhe liritë qytetarëve, të veprojnë në kohën e duhur dhe në mënyrë të ligjshme.
12. Merr pjesë në seminare, trajnime dhe konferenca, në suaza të trajtimit të çështjeve nga fushveprimtaria e departamentit dhe temave që ndërlidhen me diskriminimin, të drejtat e njeriut dhe përgjegjësit.
13. Përpilon raporte të rregullta pune nga fusha e përgjegjësive dhe detyrave të caktuara si dhe kontribuon në përgatitjen e Planit Vjetor të punës së Departamentit.
14. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe

**Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:**

- Diplomë universitare në shkencat juridike.
- Minimum 3 (tri) vjet përvojë pune profesionale.
- Njohje të shkëlqyeshme në të folur dhe të shkruar të gjuhës shqipe dhe/ose serbe, ndërsa preferohet njohja e mirë e gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar.
- Trajnime përkatëse në fushën e të Drejtave të Njeriut.
- Vërtetimin se nuk është nën hetime apo i dënuar për vepër penale, jo më i vjetër se 6 muaj.

-----  
**Procedura e konkurimit**

Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i përmbushin kriteret e konkursit.

Formularët për punësim mund të merren në zyrën e IAP, apo në ueb faqen: [www.ombudspersonkosovo.org](http://www.ombudspersonkosovo.org).

Formularët për punësim dorëzohen brenda afatit të përcaktuar me Konkurs personalisht në zyrën qendrore të Institucionit të Avokatit të Popullit në Prishtinë, Rr. „Migjeni“, nr. 21, 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, përmes postës elektronike në adresën [zyraepersonelit@ombudspersonkosovo.org](mailto:zyraepersonelit@ombudspersonkosovo.org), si dhe me anë të shërbimit postar.

Formularit për punësim i bashkëngjiten kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe dëshmitë për kualifikim, përvojë të punës, trajnimet e ndjekura si dhe vërtetimin se nuk është nën hetime apo i dënuar për vepër penale.

**Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët**

Institucioni i Avokatit të Popullit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjitha shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga pjestarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor. Data e fundit për aplikim është 21 shkurt 2017, ora 16:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Kandidatët që kanë aplikuar, por nuk janë përzgjedhur, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre pas përfundimit të procedurës së rekrutimit dhe të ankimimit. Dokumentet që nuk tërhiqen administrohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Për informata shtesë, ju lutem kontaktoni në nurmin e telefonit 038 223 782.